

Ndrit Aty Ku Je (pjesa 1)

Mirë se keni ardhur në kishën tonë, sidomos nëse je për herë të parë këtu sot. Fillojmë sot një seri të re që quhet: "Ndrit Aty Ku Je". Ne jemi aty ku jemi, në familjet tona, punët, shkollat, jo rastësisht. Perëndia do që të sjellim ndikim me anë të fuqisë që vetëm Ai na jep. Me anë të jetëve tona, gjërave që bëjmë dhe themi.

Perëndia do që të ndricojmë, të ndikojmë, të lëmë gjurmë me jetët tona. Ka persona që ikin nga kjo botë dhe lënë pas gjurmë, ndikim, kanë ndriçuar me jetët e tyre. Bota nuk duket më e zbehtë kur ikin ata, sepse ndikimi që kanë lënë vazhdon edhe pasi ata largohen.

Ndërkohë, ka të tjerë që, kur ikin nga kjo botë, nuk ndihen fare; nuk kuptohet as kur erdhën, as kur ikën.

A do që të lësh gjurmë me jetën tënde? A do që të sjellësh ndikim dhe ai të vazhdojë brez pas brezi? A do të ndriçosh, dhe ajo dritë të vazhdojë edhe pasi ti nuk je më?

Sepse ndikimi yt, vlerat e tua që ke lënë pas, besimi yt mund të zgjasin ndër breza.

Sa të krishterë ka në botë? Hajde e mendojmë kështu: Jetojmë në shek. XXI dhe bota sot ka 33% të krishterë, që janë mbi 2.3 miliardë. Ata mblidhen çdo fundjavë për të adhuruar Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit dhe asaj që bëri Ai për ne. Para 2000 vitesh Jezusi vdiq, u ringjall dhe u ngjit në qiell përsëri. Ndjekësit e tij jetuan një lloj jete, një model jete, dhe ndriçuan me jetët e tyre në atë lloj forme, saqë sot, në shek. XXI, në çdo cep të botës adhurohet Perëndia. Po sikur jeta jonë të jetë e tillë, të lëmë pas këtë lloj trashëgimie që nuk fiket nëpër shekuj?

Edhe pse Krishtërimi erdhi në Shqipëri në shekullin e parë, Pali tha te

Romakëve 15:19b '*... kështu, prej Jeruzalemit e përqark dhe gjer në Iliri, kam kryer shërbimin e ungjillit të Krishtit,*'

I dashur pasardhës i Ilirëve, stër-stër-stër... gjyshërit tanë, duhen shumë stër për 20 shekuj histori. Por ata e morën ungjillin në shekullin e parë dhe ky vend ishte plot me Ilirë që ishin ndjekës të Krishtit.

Deri në shek. XV, kur u pushtua nga Perandoria Osmane, dhe për 4 shekuj, 70% e shqiptarëve, të ndikuar në shumë forma—dhunë, dënime, taksa, blerje—ndryshuan besimin e tyre. Dhe për më keq, kemi komunizmin, i cili e fiku çdo lloj besimi, dhe vetëm në vitin 1991 u dha mundësia përsëri të predikohet ungjilli.

Tashmë në Shqipëri ka një brez të krishterësh. Pyetja është: si të vazhdojë kjo gjë, që rinisi brez pas brezi? Si të përcillet ndikimi i krishterë, drita, influenza brez pas brezi?

Pasazhi kyç i kësaj serie do të jetë nga Psalmi 112.

Psalmi 112:1 *'Aleluja. Lum njeriu që ka frikë nga Zoti dhe gjen një gëzim të madh në urdhërimet e tij.'*

Ai që ka frikë nga Zoti, që e nderon Atë, dhe kënaqet duke lexuar Shkrimin, fjalët e Tij, gjen premtimet e Perëndisë: kur ti bën diçka, Perëndia bën diçka tjetër për ty. Nëse...

Psalmi 112:2 *'Pasardhësit e tij do të jenë të fuqishëm mbi tokë, brezat e njerëzve të drejtë do të jenë të bekuar.'*

Nëse arrijmë suksese në jetë, por fëmijët tanë nuk e ndjekin Jezusin, ne kemi dështuar. Nëse ti ke gjithë pasuritë e Shqipërisë apo të botës, por nuk jeton jetën me vlerat e Perëndisë dhe nuk ua përcjell të tjerëve, ke dështuar.

Nëse unë drejtoj një kishë në rritje, por nuk drejtoj familjen time të Perëndia, unë kam dështuar.

Nga ana tjetër, imagjino se je pjesë e një brezi në këtë vend që ka përjetuar bekimet e Perëndisë si askush më parë. Kjo është mundësia jonë e artë për të përjetuar bekimet e Perëndisë, siç thotë vargu 3.

Psalmi 112:3 *'Në shtëpinë e tij ka bollëk dhe pasuri dhe drejtësia e tij vazhdon përjetë.'*

Kush janë këta njerëz? Sepse çdo premtim i Perëndisë ka një kusht. Drita lind, dhe e di kush ndrit në errësirë?

Psalmi 112:4,6 *'Drita lind në terr për ata që janë të drejtë, për njeriun e dhembshur, të mëshirshëm dhe të drejtë.'*
'sepse nuk do të lëvizet kurrë; i drejti do të kujtohet gjithnjë.'

Kush ndrit? Ai që është:

Bujar- Imagjino sikur ne të jemi brezi më bujar që ka njohur historia e Shqipërisë. Dhe këtë vlerë t'ia lëmë brezit tjetër, sepse besojë, Perëndia na bekon që të jemi bekim. Sa më bujarë të jemi, aq më shumë na beson Perëndia. Po jetojmë në një botë materialiste, ku secili dëshiron përvetësimin, dhe më shumë për t'u mburrur se çfarë ka, dhe që ka më shumë se tjetri. Drita lind, ti ndrit nëse je bujar. Po sikur ne të jemi bujarët më të mëdhenj që ka njohur ky vend dhe t'ua pasojmë këtë vlerë brezit tjetër?

Cila është e dyta?

I Mëshirshëm—të dhembshur, një brez që merakoset dhe bën për të tjerët, jo të fokusuar vetëm tek vetja, por bën për dikë në nevojë. Nëse shikon historinë e krishtërimin, në çdo qytet, vend ku fillonte kisha, pasi hapej kisha, hapej shkolla e parë dhe spitali i parë.

Si në Korçë, në fund të shek. XIX, Gjerasim Qiriazi hapi kishën ungjillore, pastaj shkollën shqipe, dhe më pas qendrën për njerëzit në nevojë. Sot e kësaj dite, Korça është qyteti me më shumë të krishterë dhe më shumë ndikim, dhe ish-qendra e atij shekulli sot është qendër për njerëzit e moshës së tretë.

Ti ndrit kur je i mëshirshëm, kur ke dhembshuri, kur bën për dikë në nevojë.

Cila është e treta?

I Drejtë - një brez i ndarë për lavdinë e Perëndisë. Vargu 6 thotë: "I drejti do të kujtohet gjithnjë." Drita që ndriçon i drejti, dhe gjurma që lë i drejti nuk do të harrohen. Vlerat që lë pas, besimi që lë pas, do të mbeten, brez pas brezi.

Për kë është ky mesazh?

Për ata që janë prindër: dëgjo këtë mesazh dhe këtë seri me veshët e një prindi për të marrë këto parime për fëmijët, familjen tënde.

Për ata që janë drejtues: tani jeni pjesëtarë të kishës sonë, të gjithë liderë jeni. Ju merrni iniciativa, ju bëni gjëra super të veçanta. Dëgjo këtë seri me veshët e liderit.

Nëse je ndjekës i Jezusit, dëgjo me veshët e një ndjekësi, sepse thirrja jonë është të arrish një më shumë për Jezusin.

Nëse je i ftuar, dëgjo me veshë krahasues për të parë se sa mund të ndihmojnë këto vlera në jetën tënde.

Si mund ta ilustruj më mirë këtë që po përpiqem të them?

Është bërë një studim për brezat dhe është gjetur një fenomen interesant që përsëritet. Gati është e pamundur të kalosh, për të lënë çfarëdo lloj gjëje nga brezi i parë te brezi i tretë. Është e vështirë që brezi i tretë të pranojë besimin, vlerat, madje edhe bizneset e brezit të parë.

Në një studim ka dalë se vetëm 10% e bizneseve arrijnë të kalojnë te brezi i tretë. Sepse nuk është e lehtë. Nuk e di sa prej jush keni pasuritë, vlerat, besimin e brezave të parë; me shumë gjasa, shumë pak.

Ne nuk kemi shumë biznesmenë në kishën tonë, por ky model është i fortë.

Studimi thotë se brezi i parë e fillon biznesin nga zero, bën sakrifica për ta nisur.

Brezi i dytë e drejton dhe e zhvillon, ndërsa brezi i tretë shpesh e shkatërron.

Kështu ndodh në 90% të rasteve. Prandaj, është e pamundur që brezi i tretë të vazhdojë të njëjtën traditë që ka nisur brezi i parë.

Për ta bërë më personale: Çfarë do të doje të pasosh në brezat e tjerë? A do që të pasosh besimin tënd, vlerat që ke për familjen, jetën, punën...? Ja pse është e vështirë kjo puna e pasimit të traditës.

Brezi i parë është një brez liderësh të fortë. Ata sakrifikojnë dhe kanë përkushtim të lartë. Ky është brezi që ka ose pjekuri shpirtërore, ose është shumë i mprehtë nga ana intelektuale, ose ka një ekonomi shumë të mirë. Brezi i parë ndërmerr rreziqe dhe ia del mbanë.

Brezi i dytë merr gati diçka që ata e pëlqejnë dhe e vlerësojnë, por që nuk e fituan vetë me forcat e tyre. Për shkak se e vlerësojnë, por nuk u lodhën vetë për të, ata nuk dinë sesi ta riprodhojnë. Kështu, qëllimi i tyre bëhet si ta mbrojnë atë.

Brezi i dytë, i nisur me motive të mira, kalon në një pozicion ruajtjeje, dhe natyrshëm u bie pasioni. Kanë frikë të rrezikojnë se mos humbasin atë që kanë dhe e ruajnë fort që mos u humbë.

Brezi i tretë, pastaj, shikon që brezi i dytë po e ruan fort atë gjë, çfarëdo qoftë, dhe thonë: "Pse e ruan aq fort, kur as nuk ta merr njeri, as nuk e duam fare?" Ky brez nuk ka më vizion për diçka të madhe dhe nuk i shtyn gjërat për të ëndërruar. Kështu, bie çdo lloj vrulli pasioni dhe zhduket ajo që nisi.

Dhe e shikon këtë lloj cikli të përsëritet shpesh edhe në Bibël.

Brezi i parë: Jozueu—komandant shumë i zoti në betejë, drejton popullin e Izraelit në tokën e premtuar. Brezi i parë rrezikoi dhe u shpërblye. Trima, guximtarë, besuan verbërisht premtimet e Perëndisë.

Por pastaj vjen...

Brezi i dytë e mori gati të trashëguar Tokën e premtuar. Ata nuk bënë luftëra; filluan të ruanin atë që kishin dhe e adhuruan Perëndinë me vakësi, si me gjysmë zemre—si një punë për t'u bërë.

Dhe pastaj vjen...

Brezi i tretë, panë që brezi i dytë po ruante atë që kishte. Panë se ishin të vakët në adhurimin e Perëndisë. Ata thanë: "Pse ta adhurojmë Perëndinë, kur këta as nuk e adhurojnë me gjithë zemër dhe e mbrojnë me fanatizëm? Nuk janë të hapur; janë të mbyllur me atë traditë që kanë. Ne as nuk duam ta konsiderojmë; nuk e duam fare besimin e tyre." Dhe u larguan nga Perëndia. Ja si thuhet...

Gjyqtarët 21:25 *'Në atë kohë nuk kishte asnjë mbret në Izrael; secili bënte atë që i dukej e drejtë në sytë e tij.'*

Çfarë bënin njerëzit? Ikën vlerat, iku besimi te Perëndia, iku mirënjohja për atë që kishin. Filluan secili në hesap të vet, duke bërë gjëra që u dukeshin interesante. Si thuhet? *Bënin atë që u dukej e drejtë në sytë e tyre*. Secili në drejtimin e vet, si një stan me 20 porta.

Nga brezi i parë, pasionant dhe besnik ndaj Perëndisë, te brezi i tretë që bënte secili në kokën e vet. Pa mirënjohje, pa nderim, pa vizion—të gjithë gangstera, të gjithë me kokën e vet, të gjithë bossa, të gjithë të parë.

Që i bie, nëse nuk jemi të qëllimshëm, nëse nuk e kemi mendjen si ta pasojmë besimin tonë, vlerat në lidhje me familjen, jetën, punën, njerëzit përreth dhe brezin pas nesh, atëherë gjithë munda ynë do të zhduket dhe do të harrohet. Secili do të bëjë sipas kokës së vet.

Por ne duam të ndriçojmë aty ku jemi, të ndikojmë ata që na rrethojnë. Nëse duam që ndikimi ynë të vazhdojë përtej nesh dhe të mos fiket, brezat pas nesh duhet të përjetojnë bekimet e Perëndisë në një masë të bollshme.

Tre sfidat që po has ky brez tani, ose tre pengesat që po has ky brez sot dhe ku mund të ikin gjërat:

Së pari, nuk po rrezikojnë shumë. Rrezikojnë pak. Në përgjithësi, sepse ka raste kur njerëzit po rrezikojnë. Po bëj një krahasim me brezin e parë të besimtarëve para vitit 2000 dhe pas vitit 2000. Ne shkonim me këmbë kudo, madje shkonim nëpër fshatra që ishin nga 30 minuta deri në 1 orë e 30 minuta me këmbë. Sot, nëse për të ardhur në kishë duhen 2 autobuza, shumë nuk vijnë fare. Ose nëse del diçka argëtuese rrugës, nuk vijnë ose...

Ose në lidhje me shkollën, kush ka shkuar me këmbë në shkollë dhe ishte mbi 15 minuta larg? Ose në lidhje me lagjen, lojërat ishin në oborre, nuk kishte celularë. Rregulli i vetëm ishte: “Kur të errësohet, hajdeni në shtëpi.” Tani, nuk i lë njeri fëmijët 10 minuta vetëm në oborin e pallatit, lëre më gjatë nëpër rrugë. Edhe kur qëndrojnë në shkallët e pallatit, janë bashkë, por secili është me celularin e vet në dorë.

Në qytet ishte rregulli: “Mos kaloni lagjen,” ndërsa në fshat ishte: “Mos kaloni lumin; luani në këtë anë të lumit.”

Atëherë luhej me shpata, lufta dhe kukafshehta. Dhe iu shkonim nga mbrapa kamioneve dhe kapeshim nga pas. Apo udhëtonim me IFA me karrocieri të hapur. Rripi i sigurimit nuk ekzistonte fare si ide; niveli i sigurisë ishte zero. Por uleshim dhe të mbaheshim në supe të karrocierisë, dhe luanim “kush rri pa duar.”

Pastaj filluan mikrobusat, dhe përsëri nuk kishte rripi sigurimi. Mami ose gjyshja ishin rripi i sigurimit; kur ndalonte, ajo vendoste dorën përpara, duke të shtrënguar fort.

Po jastikët e ajrit, çfarë janë këto? Jastiku i ajrit ishte gjyshja. Kur ndalonte makina, bab, dorën përpara, gjyshja me ato muskujt e vet—nuk kishte nga shkoje. Dhe nuk dëmtohej njeri, sepse s'i bënte kush numra nënës.

Por tani, s'ka shanse të rrezikohesh me ndonjë gjë. Këndet e lojërave janë me lodra plastike, që të mos përplasest koka e fëmijës. Ndërsa kokat tona, nëse qethemi zero, janë si viza-viza.

Mësuesi nuk duhet të përdorë stilolap të kuq për korrigjime, sepse mund të rëndohet psikologjikisht nxënësi. Nëse në klasë bëhet ndonjë lloj konkursi, ose në sport, duhet me çdo kusht që të gjithë të fitojnë diçka. Ose të marrin të gjithë certifikata. Nuk ka më "fiton më i zoti." Tani, po erdhe në klasë, do ta fitosh patjetër diçka. Nëse nuk fitojnë në diçka, do të ndihen shumë keq fëmijët e tjerë.

Çfarë po ndodh? Po e ruajmë brezin e ri nga gjërat normale. Po i mbrojmë që të mos gabojnë. Studentët nuk aplikojnë për punë, sepse thonë: "Nuk e marr atë punë dhe mërzitem." Ose nuk aplikojnë, se mos nuk e fitojnë filan projekt ose filan punë, ose filan shkollë, dhe do ndihen shumë keq.

Jemi në brezin që po i mbrojmë shumë dhe po u heqim mundësinë që të dështojnë. Por, po nuk gaboi, si do të mësojë? Po nuk provoi, nga do ta dijë sa i zoti është?

Nuk po them që duhet të jemi të çmendur. Sepse për çmenduri, të gjitha po i provojnë—nuk po ngel lokal pa tym, pipa, llulla. Por ka shumë gjëra të tjera që bëhen me çdo kusht për të mos rrezikuar këtë brez.

E dyta, nuk i kemi qejf vuajtjet, sfidat, vështirësitë. I nxjerrim sa më parë nga situata. Nëse fëmija ka ndonjë vështirësi, nuk ka bërë ndonjë projekt në shkollë, del mama heroina, blen diçka në market—ca ngjitëse, një shishe Coca Cola—dhe ia bën projektin gati. Fëmija, sa për ta mbajtur rrugës për në shkollë. Ose harron djali dhe ikën pa marrë xhupin ose pa marrë lekë me vete. Babi, me vrap, 30 minuta a më shumë nëpër trafik për t'ia çuar. Në vend që ta lërë një ditë të ketë ftohtë ose një ditë pa bukë, që të kuptojë rëndësinë e xhakëtës apo lekëve që i duhen. Nëse ndodh ndonjë gjë në shkollë, shkon mami, "*Djali im, vajza ime—jo, djali im nuk bën kështu. Do jenë ndonjë mistrec nga lagja tjetër, se s'është djali im kështu. Shih sa i mirë që është një herë.*"

Kurse në kohën tonë, prindërit thonin mësueses: "Po nuk mësoi, futja ndonjë shpullë nga unë." Nuk po them që kjo është mënyra si zgjidhen problemet në shkollë, por ne nuk na shpëtonte njeri nga situatat; mësonim dhe përmirësoheshim herën tjetër. Tani, sepse prindërit i nxjerrin shpejt nga situatat e vështira, fëmija thotë: "Hajt, mos e çaj kokën, kam mamin tim. Ia bën 8 me 2 mësueses dhe drejtorit bashkë."

Në brezin tonë, djemtë nga mosha 22-25 ishin martuar dhe kishin krijuar familje. Tani, jo të keqen, mami i thotë: *"Ti je i vogël. Unë sapo të bleva një PlayStation të ri, sapo të bleva një iPhone të ri—ku do martohesh ti? Rri me mamanë. Çfarë ke ti? Çdo ditë do të të japë mama 5 mijë lekë për kafe me shokët."* I ruajmë nga situatat e vështira, i mbrojmë nga sfidat.

Kush e mban mend djalin planprishës? Djali ikën nga shtëpia. Çfarë bën babai? Nuk shkon pas tij për ta shpëtuar. Djali mori paratë, i shpenzoi, bëri marrëzi dhe si pasojë po jetonte me derrat. Babai nuk e llastoi, e la të vuante pasojat e vendimeve që mori vetë, që të kuptonte peshën e vendimeve.

Derisa erdhi në vetëdije dhe tha: "Kështu nuk jetohet më, do bëj diçka ndryshe." Po e mbrojmë shumë brezin e ri nga pasojat e vendimeve të tyre; po gjymtohen, po llastohen dhe nuk do jenë aq të zotë. Njeriu është i lirë deri në momentin që merr vendimin; nëse vendos, pastaj duhet të marrë pasojat ose bekimet e atij vendimi.

Rrezikojmë pak, shmangim vuajtjet, vështirësitë. Cila është e treta?

E treta, u jepen më shumë shpërblime se ç' meritojnë.

U jepen shumë gjëra që duhet t'i fitojnë vetë, por i marrin pa asnjë lloj mundimi. Ua japim gjëra me motive të mira, por gjëja më e mirë do ishte që t'i fitonin vetë, për të kuptuar vlerën e tyre.

Një fëmijë 8-vjeçar ka celular 500 mijë lekë, vetëm që të mos jetë ndryshe nga shokët. Apo ka rroba që kushtojnë sa gjysma e rrogës, vetëm që të mos ndihet ndryshe nga shokët. Nuk ka gjë që nuk paguajmë dot qeranë, që nuk kemi gjëra të tjera në shtëpi, por vetëm që djali të mos ndihet keq mes shokëve.

Ai nuk ka bërë asgjë në shtëpi; njëherë nuk ka hedhur qesen e plehrave dhe nuk ka fituar as 1 mijë lekë vetë.

Është e padrejtë të shpërblehet kot pa bërë asgjë. Sepse po i mësojmë që gjërat në jetë merren kollaj, dhe kur të përballen me realitetin, do vuajnë shumë, sepse do mësojnë vonë mësimet e dhura: që në jetë gjërat nuk fitohet aq lehtë.

Dhe, natyrisht, kur të arrijnë në 20 e ca vjeç, ndihen bosh. U duket jeta e padrejtë, e pavlerë, dhe e shohin shtetin si një dështim. Përçmojnë familjen që është shpërbërë. Presin që gjërat e mëdha t'u vijnë gati, pa lodhje. Fillojnë të marrin kredi apo borxhe për të blerë gjërat e reja që kanë dalë ose që ka tjetri, dhe situata bëhet nga keq, në më keq.

Ajo që po theksohet kaq fort dhe gati-gati po adhurohet është:

Fenomeni i Lumturisë. Vetëm të jemi të lumtur. "Duam që zemra e vogël të jetë e lumtur, pa, punë e madhe për të tjerat. Le të kenë më shumë se ç' kemi patur ne, sepse ne s'kishim fare. Do bëjmë çdo gjë që ata të jenë të lumtur. Nuk do lejojmë t'u ngelet një gjemb në këmbë, sepse duam që ata të jenë të lumtur.

Nëse ajo punë s'të bën të lumtur, lëre. Nëse ajo vajza s'të bën të lumtur, lëre. Nëse martesë s'të bën të lumtur, lëre. Prandaj, 80% e divorceve ndodhin në muajt e parë të martesës ose në vitin e parë. *Nëse s'ke kënaqësi në shkollë, lëre, shko në një tjetër ose mos shko fare.*

Nëse kisha s'të bën të lumtur, mos shko më. Detyra e drejtuesve të kishës është të të bëjnë ty të lumtur.

Çifti betohet se do të jenë bashkë në ditë të mira dhe në ditë të këqija, por kur vijnë ditët e këqija, ia fusin vrapin.

“Pse u ndave?”

“Sepse nuk po më bënte më të lumtur.”

Perëndia nuk ka thënë: "Ji i lumtur, siç jam Unë i lumtur." Ai ka thënë: "Ji i shenjtë, siç jam Unë i shenjtë."

Ndërsa ne e kemi kthyer lumturinë në idhull dhe adhurojmë atë, jo Perëndinë. Por Perëndia do që të jemi të shenjtë së pari, pastaj të lumtur.

Lumturia është e përkohshme. Ti thua: "Vetëm të kem punë dhe do jem i lumtur." Je në punë, pas pak javësh ia more dorën dheee, iku lumturia. Thua: "Vetëm ta kem rrogën kaq dhe do jem i lumtur." E more rrogën aq, dhe pas ca muajsh u mësove me këtë rrogë dheee, iku lumturia.

Thua: "Vetëm të lidhem, vetëm të martohem, vetëm të kem këtë e atë..." dhe kalojnë disa muaj pas marrjes së asaj gjëje dheee, nuk je më i lumtur.

Ai që nuk është i kënaqur me atë që ka sot, ai që nuk di të shijojë atë që ka sot, nuk do të shijojë për shumë gjatë as ato që do të ketë nesër.

Po të kisha më shumë miq në Facebook, më shumë followers, më shumë shokë, më shumë gjëra, të kisha këtë, të kisha atë...

Nëse do ndjekësh lumturinë gjatë gjithë jetës, asnjëherë s'ke për ta zënë. Edhe po e zure, punë ditësh, punë kohe, do ikë përsëri. Sepse qëllimi nuk është lumturia; qëllimi është t'i sjellësh kënaqësi Perëndisë me jetën tënde.

Dhe lumturia, gëzimi, kënaqësia vijnë vetë nëse do e jetosh jetën për lavdinë e Perëndisë. Është një produkt që ndodh vetë.

Si ishte ai vargu më lart, kur do të shkëlqejë drita jote? Kur do të ndriçosh ti me jetën tënde? Kur të jesh bujar, i mëshirshëm (dhembshur) dhe i drejtë.

Nëse ti dhe unë do jemi bujarë dhe frymën e bujarisë do e përcjellim te brezi tjetër, kjo ka për të sjellë gëzim dhe kënaqësi.

Sepse ti përdor ato që ke për të ndikuar jetën e dikujt, dhe kjo do sjellë mirënjohje dhe kënaqësi. Prandaj kërkoji Perëndisë: "Të lutem, më krijo mundësinë të ndihmoj dikë, të jem bujar."

Mëshira, dhembshuria... vijnë kur kujdesesh për të tjerët. Njerëzit përreth shpesh e kanë mendjen te vetja: "Më ndihmo mua, bëj për mua..." Kjo kohë

thekson më shumë egon. Por kur ti bën për të tjerët dhe ndihmon dikë, kjo sjell gëzim dhe kënaqësi.

Drejhtësia — kur jeton jetën si i pëlqen Perëndisë, nuk bën kompromise, nuk vjedh, nuk kopjon, nuk bën hile. Ka shumë gjasa, nëse zgjedh këtë lloj jete, që të tjerët të të tallin.

Sepse vjen një moment ku ti e di se nuk mund t'i kënaqësh të gjithë, por mund të kënaqësh Perëndinë.

Dhe kur synimi yt në jetë bëhet të sjellësh kënaqësi Perëndisë dhe të përdorësh dhuntitë, aftësitë që të ka dhënë Perëndia për të ndikuar dikë, gëzimi, paqja dhe kënaqësia do vijnë vetë. Nuk ke synim kënaqësinë tënde; ke synim të ndjekësh Perëndinë.

Kështu që le të mos e kemi mendjen te lumturia e sotme, por më shumë të bëhemi gati për atë që do vijë nesër. Le të mos e kemi mendjen te lumturia e fëmijëve sot; por të përgatisim ata për jetën nesër, t'u japim vlerat e duhura, besimin dhe mjetet që u nevojiten.

Po si mund ta bëjmë këtë gjë? Do ta themi javë pas jave, prandaj është një seri. Si të ndriçosh aty ku je, si të ndikosh brezin tënd dhe brezin tjetër. Si të kesh një model jete për vete që të përjetosh maksimalisht bekimet e Perëndisë dhe si t'i lësh trashëgimi brezit tjetër.

Po ndonjëri mund të thotë: "Por unë nuk kam fëmijë akoma." Atëherë, ndiko tek fëmijët e kishës, ndiko te rinjtë, adoleshentët. Nëse nuk po bën asgjë për brezin e ri, pyetja do ishte: "Çfarë të pengon?"

Të gjitha ato përvoja që ke marrë nga jeta, gjithë ai hir që të është dhënë nga Zoti, nuk duhet t'i mbash vetëm për vete. Pasoje besimin te brezi i ri, thuaji një fëmijë sa shumë e do Perëndia. Qëndroi afër një adoleshenti të lënduar dhe kujtoi se Perëndia e do ashtu siç është sot.

Këtë do synojmë në këtë seri: si të ndriçosh, si të ndikosh me jetën tënde duke qenë bujar, duke qenë i dhembshur dhe i drejtë.

Ja si tha Davidi, babai i Salomnit:

1 i Kronikave 28:9-10 *'Ti Salomon, biri im njihe Perëndinë e atit tënd dhe shërbeji me gjithë zemër dhe me shpirt vullnetmirë, sepse Zoti heton të gjitha zemrat dhe kupton tërë qëllimet e mendimeve. Në rast se ti e kërkon, ai do të të lërë ta gjesh; por në rast se ti e braktis, ai do të të hedhë poshtë përjetë. Tani ki parasysh që Zoti të ka zgjedhur për të ndërtuar një shtëpi si shenjtërore; tregohu i fortë dhe futju punës!'*

Futju punës, merre seriozisht. Zoti të ka zgjedhur për të ndërtuar tempullin e tij. Tregohu i fortë dhe puno fort.

Babai po i thotë birit, një brez po i thotë tjetrit: “**Ti** mund të bësh shumë më shumë se çfarë kam bërë unë. Ji i fortë. I ke të gjitha që të nevojiten për të shkëlqyer. Unë nuk do të ndihmoj, por po të urdhëroj: kërkoje Perëndinë, njihe Perëndinë.

Bëj atë për të cilët të ka thirrur Ai. Ji i fortë. Lëri gjurmë me jetën tënde, ndriçoje dritën tënde. Unë do të ndikoj tek ti, dhe ti ke për të bërë shumë më shumë se çfarë kam bërë unë.”

Si thua, a je gati për këtë lloj jete? Për këtë lloj jete të madhe, një jetë që do të përjetosh bekimet e Perëndisë si asnjë brez më parë në Shqipëri dhe të lësh trashëgimi për vete dhe fëmijët e tu, si asnjë brez më parë?

Kjo është mundësia jote. Shpresa jonë është te Perëndia dhe te parimet që na ka lënë Ai në këtë libër.

Le të lutemi.

Lutja e shpëtimit.